

RREGULLAT DHE KUSHTET E SHËRBIMIT TË PARASË ELEKTRONIKE UNION FINANCIAR TIRANË (UFT)

Neni 1

Baza Ligjore

- 1.1 Kjo kontratë hartohet dhe do të interpretohet në përputhje me Kodin Civil të Republikës të Shqipërisë, Ligjin Nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për Tregtinë Elektronike” (i ndryshuar), Ligji Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” .
- 1.2 Çdo çështje që nuk gjen rregullim në këtë Kontratë do të rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 2

Terma kryesore

- 2.1 **Përdoruesi/Klienti:** është individ, personi fizik apo juridik i cili regjistrohet në UFT për të marrë nga platforma të gjitha shërbimet sipas kësaj Kontrate;
- 2.2 **Tregtari:** është personi fizik apo juridik, partner i UFT, i cili shet mallrat/shërbimet e tij nëpërmjet sistemit UFT. Tregtari përfiton kushte shërbimi të përcaktuara në Kontratë;
- 2.3 **Banka:** është një institucion financiar që iu ofron shërbime bankare klientëve të saj (në rastin tonë Përdoruesit/Klientit), në bazë të një marrëveshjeje apo marrëdhënieje kontraktore të lidhur ndërmjet tyre;
- 2.4 **Llogaria UFT:** është llogaria e Përdoruesit/Klientit, e cila hapet menjëherë pas regjistrimit. Mbi bazën e kësaj Kontrate, fondet e përdoruesit/klientit të cilat ndodhen në llogarinë apo kartën e tij bankare, mund të përdoren për shërbimet që UFT ofron. Kjo llogari nuk përbën depozitë bankare dhe Përdoruesi/Klienti nuk do të përfitojë interes nga këto fonde.
- 2.5 **Paraja elektronike:** është para jo-CASH- nëpërmjet së cilës mund të kryhen transaksione me mjete elektronike, si nëpërmjet kartave të debitit (me parapagesë), ashtu edhe me kartat e kreditit nëpërmjet të cilave mundësohet qarkullimi i parasë elektronike.
- 2.6 **Shërbimi UFT:** për qëllim të kësaj Kontrate ka kuptimin e pagesës nga llogaria UFT, në emër dhe për llogari vetëm të Përdoruesit/Klientit, për çdo mall/shërbim që është listuar për shitje dhe për të cilin Përdoruesi/Klienti ka fonde të mjaftueshme për t’i paguar;
- 2.7 **Transaksioni i Pagesës:** për qëllim të kësaj Kontrate ka kuptimin e veprimit financiar që konsiston në debitimin e llogarisë UFT (fondet) të blerësit dhe kreditimin e llogarisë së përfituesit (tregtarit) për vlerën e mallit/shërbimit;
- 2.8 **Fjalëkalimi:** është element sigurie e identifikimi që UFT i jep Përdoruesit/Klientit në momentin e regjistrimit, automatikisht nga sistemi. Fjalëkalimi i shërben Përdoruesit/Klientit

të hyjë në platformë e të kryejë pagesat. Përdoruesi/Klienti mund ta ndryshojë fjalëkalimin e tij, por duhet ta mbajë atë të fshehtë.

- 2.9 **Shuma e blerjes:** është vlera e pagesës së një malli/shërbimi të përftuar nga UFT, plus tarifat nëse ka, të aplikueshme në monedhën Lekë.
- 2.10 **Mashtrim:** për qëllim të kësaj Kontrate ka kuptimin e dhënë nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Mashtrim është çdo veprim dhe/ose mosveprim i Përdoruesit/Klientit dhe /ose çdo pale të tretë që përben vepër penale dhe është i dënueshëm sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.11 **Të dhëna Personale:** për qëllim të kësaj kontrate ka kuptimin e çdo informacioni që identifikon përdoruesin/klientin i përdorur për qëllim të kësaj kontrate dhe konsiderohet e dhënë personale sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 3

Regjistrimi i Përdoruesit/Klientit

- 3.1 Çdo subjekt (individ, person fizik, ose juridik) që kërkon të regjistrohet dhe i është pranuar/konfirmuar rregjistrimi nga UFT si Përdorues/Klient i platformës së UFT do të përfitojë shërbimet e pagesave të shpejta që ofron UFT. UFT miraton apo refuzon aplikime për regjistrim, apo regjistrime ekzistuese në përputhje me ligjet në fuqi, dhe që nuk përfshihet në këtë Kontratë.
- 3.2 Platforma UPay është e ndaluar të përdoret nga persona nën moshën 18 vjeç, ose nga çdo person tjetër i ndaluar apo i përjashtuar më parë nga përdorimi i platformës.
- 3.3 Për të përdorur platformën UPay, Përdoruesi/Klienti duhet të plotësojë të gjithë elementet e informacionit të kërkuar në faqen e regjistrimit.
- 3.4 Përdoruesi/Klienti duhet të regjistrojë një numër të vlefshëm celulari, i cili do të bashkëngjitet në llogarinë të tij UFT.
- 3.5 Përdoruesi/Klienti gjatë fazës së regjistrimit duhet të plotësojë të dhënat e tij personale e të vendosë në llogari një kopje të dokumentit të identifikimit. Përdoruesi/Klienti merr një e-mail informues rreth UFT në adresën e tij dhe me një fjalëkalim të përkohshëm, të cilin duhet ta ndryshojë. Përdoruesit/Klientit i dërgohet një SMS me një kod për të verifikuar numrin e celularit të regjistruar në llogari. Pasi ai të ketë plotësuar këto kushte bëhet regjistrimi përfundimtar në platformë.
- 3.6 Përdoruesi/Klienti është përgjegjës për dhënien e informacioneve të plota, të sakta e të përditësuara.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e UFT

- 4.1 UFT sh.a është një shoqëri që ofron kryerjen e pagesave online nëpërmjet faqes së saj zyrtare dhe nëpërmjet aplikacionit të saj “UPay” në telefonat celularë (aktualisht i mundësuar në platformat Android dhe IOS).

- 4.2 UFT vepron me fondet e Përdoruesit/Klientit në llogarinë UFT, vetëm nëse ka marrë një udhëzim nga Përdoruesi/Klienti për kryerjen e një pagese, si dhe vetëm për qëllimin e udhëzuar prej tij.
- 4.3 Nëse vlera e pagesës është më e madhe se balanca/gjendja në llogarinë UFT, atëherë sistemi lejon kryerjen e pagesës direkt nga karta bankare. UFT nuk mban përgjegjësi për moskryerjen e pagesës në rast se Përdoruesi/Klienti nuk ka balancë/gjendje në llogarinë e tij UFT apo fondet në llogarinë e kartës janë të pamjaftueshme, ose në rast se karta e tij bankare nuk lejohet nga banka të kryejë transaksione on line.
- 4.4 UFT nuk kontrollon dhe nuk mban përgjegjësi për gjendjet dhe aksesin në llogaritë e kartave bankare të Përdoruesit/Klientit.
- 4.5 UFT ruan të drejtën që t'i njohë Përdoruesit/Klientit bonus ose stimul, me afatet dhe kushtet e zbatueshme për çdo program bonusi, ose stimuli në fuqi. UFT ruan të drejtën të përfundojë çdo program promovues në çdo kohë, por duke e njoftuar Përdoruesin/Klientin.
- 4.6 UFT bazuar në gjykimin, analizën dhe vlerësimin e rastit, rezervon të drejtën të refuzojë kërkesën e Përdoruesit/Klientit për transaksionet e pagesave, të kufizojë apo blloktojë pagesën e një Përdoruesi/Klienti të caktuar.
- 4.7 Për arsye sigurie, mund të vendosë në çdo kohë kufizime shtesë mbi numrin dhe shumën e transaksioneve të pagesave që mund të kryhen duke përdorur platformën UFT.
- 4.8 Në rastet kur UFT nuk është e bindur për vërtetësinë e të dhënave të identitetit, në formularin e regjistrimit të Përdoruesit/Klientit, dhe kur ky i fundit nuk i përgjigjet kërkesave për të dhëna shtesë lidhur me identitetin e tij, atëherë UFT ka të drejtën të kufizojë numrin dhe shumën e transaksioneve që Përdoruesi/Klienti kërkon të kryejë, ose të refuzojë kryerjen e transaksioneve. Këto kufizime do të hiqen në rastin kur Përdoruesi/Klienti të ketë dhënë informacionin e vërtetë bindës për UFT.
- 4.9 Në zbatim të kësaj Kontrate, nëse UFT dështon në kryerjen e një pagese për llogari të Përdoruesit/Klientit, në kohën ose në shumën e duhur, ka detyrimin të rimbursojë ndaj Përdoruesit/Klientit vetëm vlerën e pagesës së urdhëruar nga Përdoruesi/Klienti dhe kostot shtesë administrative (në rast se aplikohen), të nevojshme për rikryerjen e pagesës së urdhëruar nga Përdoruesi/Klienti.
- 4.10 UFT nuk do të jetë përgjegjëse :
- për dështimin e kryerjes së pagesës së urdhëruar në asnjë nga rastet e mëposhtme:
- a) nëse Përdoruesi/Klienti nuk ka fonde të mjaftueshme për të kryer pagesën e parave;
 - b) nëse fondet e Përdoruesit/Klientit janë subjekt i ndonjë mase/vendimi gjyqësor, ose ekziston ndonjë pengesë tjetër ligjore që kufizon përdorimin e tyre;

- c) nëse platforma UPay nuk funksionon normalisht dhe Përdoruesi/Klienti është në dijeni të këtij fakti para se të proçedojë me pagesën;
 - d) nëse rrethanat janë përtej kontrollit të arsyeshëm të UFT (si zjarr, përmbytje, ose veprime të palës së tretë, ngjarje madhore, etj.) pengojnë pagesën, pavarësisht masave paraprake që UFT ka ndërmarrë;
 - e) nëse moskryerja e pagesës vjen si pasojë e një dështimi në komunikim, si për shembull: nëse komunikimi midis UFT dhe Tregtarit ka rënë në ato momente;
 - f) nëse si pasojë e informacionit të pasaktë, ose të paplotë të Përdoruesit/Klientit pagesa nuk mund të kryhet;
 - g) nëse pagesa duket e dyshimtë, mashtruese, e paautorizuar, ose në kundërshtim me rregullat e ligjet në fuqi.
- 4.11 UFT nuk kontrollon apo mban përgjegjësi për cilësinë e shërbimeve të paguara nëpërmjet UFT por është përgjegjës vetëm mbi vërtetësinë e transaksionit të kryer nga Përdoruesi/Klienti në përputhje me këtë Kontratë dhe kushtet e punës për këtë shërbim.
- 4.12 Përdoruesi/Klienti mund të informohet mbi balancën dhe veprimet e kryera në llogari (“Historiku i Llogarisë”) nëpërmjet internetit, duke hyrë në llogarinë e tij në UFT nga faqja zyrtare UFT.al seksioni UPay, ose nëpërmjet aplikacionit në celularë.
- 4.13 Transaksioni i Pagesës
- a) Platforma UPay realizon kryerjen e pagesave nga Përdoruesi/Klienti tek Tregtari.
 - b) UFT ruan të drejtën ekskluzive të anullopë kryerjen e pagesave për transaksione të dyshimta, të cilat mund të përfshijnë mashtrimin, shkelje të ligjeve në fuqi, shkelje të kushteve të mëposhtme të shërbimit për Përdoruesit/Klientët, apo të politikave të tjera të publikuara nga UFT në faqen e web-it.
 - c) Përdoruesi/Klienti mund të kërkojë anulimin e një transaksioni të kryer nga llogaria e tij në UPay duke shkruar drejt adresës sherbimiklientit@uft.al brenda ditës në të cilën ka kryer pagesën. Kërkesa për anulim transaksioni do të merret në shqyrtim vetëm për rastet kur Përdoruesi/Klienti ka vendosur gabim shumë e pagesës. Anullimi mund të kryhet vetëm për shumë e plotë të transaksionit. Pas kryerjes së verifikimeve të nevojshme të kërkesës së paraqitur për anulimin e një transaksioni, UFT komunikon me Përdoruesin/Klientin për kryerjen e anulimit të transaksionit dhe sistemit të fondeve të Klientit në llogarinë e UPay.
 - d) Të gjitha transaksionet e pagesave duhet të jenë në përputhje me legjislacionin shqiptar.
 - e) Të gjitha transaksionet kryhen në monedhën Lekë (ALL).

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Përdoruesit/Klientit

5.1 Përdoruesi/Klienti njih dhe pranon që blerjet e shërbimeve janë transaksione midis Përdoruesit/Klientit e Tregtarit. UFT nuk mban përgjegjësi për mosfurnizim apo mosplotësim të cilësive të shërbimit që varen nga tregtari.

5.2 Si Përdorues/Klient i platformës UPay, Përdoruesi/Klienti deklaron dhe garanton në mënyrë të parevokueshme se nuk do të:

- a) përdorë platformën UPay nëse është nën 18 vjeç;
- b) përdorë platformën UPay për arsye të tjera përveç pagesave, dhe të aksesojë atë në përputhje dhe sipas udhëzimeve të UFT;
- c) përdorë platformën UPay me identitetin e personave të tjerë duke fallsifikuar të dhënat e një përdoruesi tjetër, apo të aksesojë llogarinë UFT të dikujt tjetër;
- d) përdorë platformën UPay apo të kërkojë kryerjen e transaksioneve për qëllime të paligjshme, në shkelje të ligjeve në fuqi, përfshirë por pa u kufizuar në ligjet që rregullojnë fushën e taksave, të pronësisë intelektuale, mbrojtjes së të dhënave, pastrimit të parave etj;
- e) shkelë të drejtën e pronësisë intelektuale të UFT apo palëve të treta, të drejtën e reklamës dhe konfidencialitetit;
- f) angazhohet në pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit;
- g) përdorë shërbimin e transaksionit të pagesës për ndonjë produkt që shkel kushtet e shërbimit, politikat apo rregullat e tjera të zbatueshme nga UFT;
- h) refuzojë të bashkëpunojë në një hetim apo të japë informacione për identitetin, të kërkuara nga UFT, apo institucionet përgjegjëse shtetërore;
- i) ndërhyjë në sigurinë e sistemit, apo faqes së UFT dhe shërbimeve të tjera të saj;
- j) përdorë platformën UPay në mënyrë që mund ta dëmtojë, çaktivizojë, mbingarkojë, modifikojë, adoptojë, përkthejë, apo krijojë punime derivative të bazuara në platformën e UPay, apo pjesë të saj;
- k) ndërhyjë qëllimisht në dëmtimin e operacioneve të UFT, apo të një përdoruesi të regjistruar duke përfshirë këtu ngarkimin e viruseve, adwareve, spywareve, dhe kodeve të tjera dëmtuese;
- l) kryejë veprime që mund të shkaktojnë humbjen e shërbimit të ofruar nga të tretët për UFT.

5.3 Sipas politikave aktuale të UFT, produktet/shërbimet që nuk mund të paguhen nëpërmjet sistemit të UFT-së janë: 1) Armët, 2) Alkooli, 3) Eksplozivët, 4) Materialet pornografikë dhe shërbimet e lidhura me to, 5) Kafshët e gjalla, 6) Drogat ilegale, ose substanca të tjera të kontrolluara, 7) Fishekzjarrët, ose pajisje të ngjashme, 8) Materialet e rrezikshme, lëndë djegëse, gërryese, 9) Anëtarësimi në faqet e pornografisë, 10) Produkte e shërbime të tjera që ndalohen nga ligji dhe aktet normative në fuqi.

5.4 Përdoruesi/Klienti pranon në mënyrë të parevokueshme në përputhje me nenin 686 te Kodit Civil miratimin e të drejtës nga UFT që të: (i) refuzojë regjistrimin si Përdorues/Klient i

platformës së UFT në rast se konstaton të dhëna, informacione, deklarime të rreme, të pasakta në kundërshtim me kushtet e kësaj kontrate duke e njoftuar klientin me (email) brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e aplikimit për regjistrim; (ii) pezullojë apo refuzojë shërbimin në rast se konstaton kryerje të veprimeve të ndaluara si më sipër, apo kufizime të veprimeve siç janë parashikuar në këtë Kontratë, si dhe të drejtën për të marrë të gjitha veprimet ligjore (administrative-civile-penale) sipas legjislacionit në fuqi.

5.5 Përdoruesi/Klienti është përgjegjës për ruajtjen e fshehtësisë së fjalëkalimit të tij.

5.6 Përdoruesi/Klienti është përgjegjës nëse u jep akses për të përdorur fjalëkalimin e tij personave të tretë për të kryer transaksione në emër dhe për llogari të përdoruesit/klientit.

5.7 Pasojat e përdorimit, ose keqpërdorimit të fjalëkalimit të tij:

a) Nëqoftëse Përdoruesi/Klienti përfaqëson një biznes, ai mban vetë përgjegjësi për të gjithë punonjësit, agjentët, përfaqësues dhe të tjerë që, kanë të drejtën e përdorimit të të dhënave dhe fjalëkalimit për të përdorur platformën UPay; kanë prej tij (Përdoruesit/Klientit) autoritetin për ta përdorur këtë shërbim; si dhe përfaqësojnë ligjërisht blerësin.

b) Përdoruesi/Klienti do të jetë përgjegjës për të gjitha veprimet e punonjësve, agjentëve, përfaqësuesve e të tjerë që punojnë aktualisht ose kanë punuar më parë te Përdoruesi/Klienti, pavarësisht nga fakti nëse janë ose jo të autorizuar prej tij, dhe që kanë ose jo akses në platformën UPay, si dhe që përdorin fjalëkalimin e tij.

5.8 Përdoruesi/Klienti është përgjegjës për të dëmshpërblyer, ruajtur dhe mbrojtur UFT, kontraktorët e tij, punonjësit, pikat e licencuara dhe partnerët të sigurtë nga të gjitha deklaratat, humbjet, dëmtimet, detyrimet, kostot dhe shpenzimet, duke përfshirë pa kufizim taksat ligjore dhe shpenzimet që dalin, ose në lidhje me keqpërdorimin e sistemit UFT nga Përdoruesi/Klienti, çdo shkelje të kësaj kontrate, ose çdo shkelje të përfaqësimeve dhe garancive të përcaktuara në këtë marrëdhënie.

5.9 Përdoruesi/Klienti duhet të njoftojë menjëherë për një përdorim të paautorizuar të fjalëkalimit, ose çdo shkelje tjetër në lidhje me sigurinë e shërbimit për të cilat ka dijeni.

5.10 Në rast të vjedhjes, ose humbjes së fjalëkalimit, Përdoruesi/Klienti duhet të kontaktojë menjëherë UFT nëpërmjet shërbimit të klientit, në numrin e telefonit: +355 4 2234979, 08004455 (pa pagesë) dhe në adresën: sherbimiklientit@uft.al.

5.11 Gjithashtu, nëse historiku i llogarisë UFT të Përdoruesit/Klientit tregon veprime të cilat nuk janë kryer nga Përdoruesi/Klienti, ky i fundit duhet të njoftojë menjëherë UFT në të njëjtat kontakte si më lart në pikën 5.10.

5.12 Përdoruesi/Klienti merr vetë përsipër të përdorë pajisjet dhe programet e duhura për t'u mbrojtur nga sulme të jashtme (viruse, site të ndryshme, etj.).

UFT nuk është përgjegjëse për dëme të ndryshme që mund t'i shkaktohen klientit nga përdorimi jo i përshtatshëm i pajisjeve, apo internetit nga ana e tij (klientit).

Klienti/Përdoruesi pranon në mënyrë të parevokueshme në përputhje me nenin 686 të Kodit Civil se, UFT nuk është dhe nuk do të jetë përgjegjëse në formë direkte, apo indirekte për dëme të ndryshme që mund t'i shkaktohen Klientit nga përdorimi i pajisjeve elektronike, apo për çfarëdo shkak tjetër që nuk është në përgjegjësinë e UFT.

Neni 6

Tarifa e Komisione

6.1 Përdoruesit/Klientët e UFT nuk paguajnë asnjë tarifë apo komision regjistrimi e mirembajtje llogarie. UFT ruan ekskluzivisht të drejtën e ndryshimit të politikave të tarifave dhe i publikon paraprakisht këto ndryshime në faqen zyrtare te internetit: UFT.al. Përveç tarifave të UFT ndaj palëve të treta, mund të aplikohen tarifa apo detyrime të tjera lidhur me përdorimin e platformës UPay, si për shembull:

6.1.1 Banka apo institucioni financiar që mban depozitën monetare, si dhe transferon fonde për llogari të Përdoruesit/Klientit mund të zbatojë tarifa për transfertat e kryera nga llogaria, apo karta bankare e Përdoruesit/Klientit në llogarinë UFT;

6.1.2 Për përdorimin e kartave bankare (kreditit apo debiti) mund të paguhen tarifa sipas rregulloreve të institucioneve financiare që kanë lëshuar këto karta.

Neni 7

Politikat e sigurisë dhe informacioni konfidencial

7.1 Informacion konfidencial do të konsiderohet çdo informacion që lidhet me zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në sekrete tregtare, të dhëna teknike, know-how, projekte, ide, plane biznesi, informacione mbi klientë, agjentë, marrëveshje, negociata për të lidhur marrëveshje, si dhe marrëdhënie të tjera tregtare (“Informacioni konfidencial”).

7.2 Informacioni konfidencial nuk do të përdoret për ndonjë qëllim tjetër që nuk lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësiive sipas kësaj kontrate. Çdo transmetim, apo dhënie informacioni konfidencial personave të tretë do të mund të kryhet vetëm sipas miratimit paraprak nga UFT.

7.3 UFT mund të japë informacione lidhur me llogarinë UFT të Përdoruesit/Klientit dhe lëvizjet me fondet e tij palëve të treta vetëm:

- a) për të realizuar dhe konfirmuar pagesën;
- b) për të verifikuar të dhëna mbi llogarinë UFT të Përdoruesit/Klientit për një palë të tretë, si Banka me të cilën UFT bashkëpunon;

- c) në zbatim të legjislacionit në fuqi, apo urdhërit të autoriteteve kompetente;
- d) për të ndaluar mashtrimin, vjedhjen, apo abuzimin me platformën.

7.4 Në momentin e regjistrimit si Përdorues/Klient në UFT, Përdoruesi/Klienti ka pranuar që UFT dhe palë të treta të lidhura me UFT, të marrin informacion mbi të (Përdoruesin/Klientin) për të ndaluar mashtrimin dhe abuzimin. Kjo mund të përfshijë marrjen e informacionit nga palë të treta mbi Përdoruesin/Klientin dhe pajisjen e përdorur prej tij, si dhe krahasimin e këtij informacioni me atë të ruajtur në bazën e të dhënave të UFT. Përdoruesi/Klienti lejon UFT të dërgojë e-maile në lidhje me përdorimin e platformës UPay, por gjithsesi UFT nuk është e detyruar t'i dërgojë këto e-maile apo mesazhe tek Përdoruesit/Klientët.

7.5 Në çdo rast të humbjes ose vjedhjes së të dhënave, kartës/kartave, pajisje elektronike (celular, tablet, laptop, etj.) dhe çdo informacioni të disponuar nga Përdoruesi/Klienti për qëllime të kësaj kontrate, Përdoruesi/Klienti është i detyruar të njoftojë UFT brenda 24 orësh. Në të kundërt është Përdoruesi/Klienti përgjegjës për çdo dëm që i shkaktohet UFT si pasojë e mosnjoftimit brenda afatit të përcaktuar dhe/ose neglizhencës së klientit/përdoruesit për të raportuar ngjarjen e ndodhur (humbja, ose vjedhja e të dhënave, kartës/kartave dhe çdo informacioni të disponuar).

7.6 Në rast se Përdoruesi/Klienti nuk i përmbahet politikave të sigurisë, ai mban përgjegjësi të plotë për humbjet që mund të shkaktohen deri në momentin kur Përdoruesi/Klienti lajmëron UFT për probleme me të dhënat, kartën.

7.7 UFT nuk mban asnjë përgjegjësi për çdo humbje apo keqpërdorim të të dhënave, kartës nga ana e Përdoruesit/Klientit, në rast se Klienti nuk e njofton UFT.

Neni 8

Mbrojtja e të Dhënave Personale

8.1 Të gjitha të dhënat personale që UFT disponon janë të dhëna personale të vendosura në dispozicion nga vetë Klienti/Përdoruesi për qëllim të kësaj kontrate. UFT zbaton legjislacionin në fuqi lidhur me mbajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave personale.

8.2 UFT mbron të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, nga aksesit ose përhapja nga persona të paautorizuar, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me masat e përshtatshme tekniko-organizative të shoqërisë.

8.3 Të dhënat personale të Klientit/Përdoruesit përdoren për qëllime të kësaj kontrate dhe përjashtime bëhen vetëm në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

8.4 Të dhënat personale ruhen për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar.

Neni 9

Të drejtat e pronësisë intelektuale

9.1 Platforma UPay është nën pronësinë e UFT sh.a. Ndërfaqet vizuale, grafike, skicimet, përpilimet, informacionet, kodet kompjuterike, produktet, software, shërbimet, dhe të gjitha elementet e tjera të platformës UPay të siguruar nga UFT (“Materialet”) janë të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e pronësisë intelektuale dhe ligjet e zbatueshme.

9.2 Në marrëdhënien midis Përdoruesit/Klientit dhe UFT, të gjitha materialet, markat tregtare, markat e shërbimit dhe emrat tregtarë që ndodhen në sistemin UFT mbeten pronë e UFT dhe/ose palës së tretë ofruese të shërbimit.

9.3 Përdoruesi pranon të mos transmetojë, të fshehë, ose të transformojë të drejtën e autorit, ose të drejta të tjera pronësie të UFT, ose palëve të treta në marrëdhënie me UFT, të përmbajtura ose të aksesueshme në lidhje me, apo nëpërmjet sistemit UFT.

9.4 UFT rezervon të gjitha të drejtat të cilat nuk i janë dhënë shprehimisht Përdoruesit/Klientit në këtë Kontratë.

Neni 10

Deklarimet e pasakta ose të rreme

10.1 Në rast të deklarimeve të pasakta, ose të rreme nga Përdoruesi/Klienti për qëllime të kësaj kontrate, UFT ka të drejtë të ndërpresë në mënyrë të menjëhershme Kontratën duke e njoftuar Përdoruesin/Klientin në adresën elektronike/postare të deklaruar prej tij dhe sipas rastit, nisjen e procedurave ligjore ndaj Klientit/Përdoruesit.

10.2 Në rast dëmshpërblim si pasojë e deklarimeve të pasakta, ose të rreme UFT ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 11

Trajtimi i Mashtrimit/Masat parandaluese

11.1 Çdo rast mashtrimi do të konsiderohet vepër penale e dënueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

- 11.2 Përdorimi me keqbesim i të dhënave të disponuara për qëllim të kësaj kontrate nga Përdoruesi/Klienti dhe/ose palë treta me qëllim një përfitim ekonomik të padrejtë, ose për t'i shkaktuar dëm UFT dhe/ose një pale të tretë, do të përbëjë mashtrim në kuptim të kësaj kontrate.
- 11.3 Për qëllim të kësaj kontrate mashtrim do të konsiderohet, por pa u kufizuar në: futja, ndryshimi, fshirja ose heqja e të dhënave kompjuterike, apo ndërhyrja në funksionimin e sistemit kompjuterik të UFT, me qëllim për t'i siguruar vetes apo të tretëve, me mashtrim, një përfitim ekonomik të padrejtë, apo për t'i shkaktuar një të treti pakësimin e pasurisë.

Neni 12

Përfundimi i Kontratës

- 12.1 Përdoruesi/Klienti pranon në mënyrë të përvokueshme në përputhje me nenin 686 të Kodit Civil se, UFT në gjykimin e saj të pavarur, pa penalitet, në çdo kohë mund të pezullojë dhe/ose të përfundojë të drejtën e përdorimit të platformës UFT nga Përdoruesi/Klienti duke e njoftuar Përdoruesin/Klientin në adresën elektronike/postare të deklaruar prej tij.
- 12.2 Me përfundimin e kësaj Kontrate për çfarëdo arsye, Përdoruesi/Klienti pranon të ndalojë përdorimin e platformës UPay.
- 12.3 Me konstatimin e një veprimi të parregullt, abuziv apo mashtrim nga ana e Përdoruesit/Klientit, UFT do të raportojë tek organet kompetente ligjzbatuese.
- 12.4 Përdoruesi/Klienti mund ta përfundojë këtë kontratë në çdo kohë duke i dërguar një njoftim me shkrim UFT.

Neni 13

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim nga palët. Në rast të kundërt mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 14

Ndryshimi i Kontratës

- 14.1 Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis palëve. Diskutimet verbale dhe parashtrimet e bëra gjatë negociimit për lidhjen e saj nuk përbëjnë kushte të kësaj kontrate.
- 14.2 UFT ka të drejtë të ndryshojë, shtojë apo të heqë pjesë të kësaj kontrate në çdo kohë duke bërë një njoftim paraprak me shkrim Përdoruesit/Klientit, ose nëpërmjet ndryshimeve të publikuara

në faqen zyrtare të internetit të UFT. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi dhe do të konsiderohen si të vlefshme dhe të pranuar nga Përdoruesi/Klienti 24 orë pas njoftimit, ose publikimit në faqen e internetit të UFT. Këto ndryshime do të aplikohen në ditën vijuese brenda 24 orëve nga njoftimi, ose publikimi në faqen e internetit të UFT. Në rast se, Përdoruesi/Klienti nuk është dakord me këto ndryshime ka të drejtën të përfundojë bashkëpunimin me UFT dhe përdorimin e platformës së saj. Shërbimet që ofrohen nga UFT pasqyrohen në faqen e internetit www.uft.al, seksioni UPay. Dispozitat e secilës pikë dhe nënpikë të kësaj kontrate do të jenë të zbatueshme pavarësisht nga njëra-tjetra dhe vlefshmëria e njëres nuk do të ndikohet nga pavlefshmëria e tjetrës.

- 14.3 UFT ka të drejtën ta transferojë këtë kontratë, udhëzimet e të drejtat e akorduara nëpërmjet saj tek palë të treta, duke njoftuar paraprakisht Përdoruesin/Klientin.

Deklaratë e Klientit:

Jam njohur dhe kam pranuar në veçanti secilën nga kushtet e kufizimit të të drejtave sipas nenit 686 të Kodit Civil dhe gjithashtu në tërësi të gjithë nenet e kësaj Kontrate, Rregullat dhe Kushtet e Shërbimit të Parasë Elektronike të Union Financiar Tiranë të paraqitura në këtë dokument dhe faqen zyrtare në web www.uft.al, seksioni UPay.